**R E P U B L I K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 135, datë 27.07.2023

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, TË PRONËS SË PALUAJTSHME ME NUMËR PASURIE 36, ZK 8517; NR. 37, ZK 8517, NR. 338/2, ZK 8517, DHE NR. 338/1, ZK 8517, QË DO TË PËRDOREN NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE, DHE PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE APO SHËRBIMEVE TË TJERA NË FUNKSION TË BASHKISË**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, nenit 3, të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 15, datë 30.6.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e kërkesës për transferim në pronësi të Bashkisë Durrës, të pronës së paluajtshme me numër pasurie 36, ZK 8517; nr. 37, ZK 8517, nr. 338/2, ZK 8517 dhe nr. 338/1, ZK 8517, që do të përdoren në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, dhe për realizimin e

funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkisë, sipas formularit për inventarizimin e pronave shtetërore dhe planrilevimit të pronës bashkëlidhur dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Ligjore (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve) për ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore nëpërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kjo në zbatim të Ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 500, datë 14.8.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 28.07.2023**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - BASHKIA DURRËS

**Lidhja 1**
**Bashkia Durrës, Njësia Durrës**

| **Numri rendor i pronës në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 1 | Prona që do të përdoren në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe për realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkisë | Në pronësi |
| 2 | Prona që do të përdoren në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe për realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkisë | Në pronësi |
| 3 | Prona që do të përdoren në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe për realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkisë | Në pronësi |
| 4 | Prona që do të përdoren në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe për realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkisë | Në pronësi |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - BASHKIA DURRËS

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
## (Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: **Fatjon Zeqiri** (Specialist) ________ **Ervis Bahiti** (Specialist) ________
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
**Pranvera Gagani** (Pergj.Sek.Pronave)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia / Komuna : **Durres**

Supervizoi: **Elio Jani**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Emiriana Sako**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

Fusha e perdorimit te Prones: Pona qe perdoren ne fushen e infrastruktures dhe sherbimeve publike , si dhe per realizimin e funksioneve apo sherbimeve te tjera ne funksion te Bashkise

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS - Drejtoria Ligjore - Kryetari i Bashkise

| Nr. Rend. | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 8517 K-34-87-(239-A) | | Truall | ECO Park Bashkia Durres | **145994 m2** | | Per realizimin e e sherbimeve ne funks. Te Bashkise | Bashkia Durres | Bashkia Durres | Kjo pasuri perfshin pasurite ( 36, 338/2, 338/1, 37) |
| | | 36 | " | | 73282 m2 | | " | " | " | Pasuria 36 me sip 73282 m2 |
| | | 338/2 | | | - 1814 m2 | | " | " | " | Pasuria 338/2 me sip 1814 m2 |
| | | 338/1 | | | 1959 m2 | | " | " | " | Pasuria 338/1 me sip 1959m2 |
| | | 37 | " | | 68939 m2 | | " | " | " | Pasuria 37 me sip 68939 m2 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - BASHKIA DURRËS

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI _SHTET_ DATE 23/06/2023 QELLIMI_PER REGJISTRIM

VENDNDODHJA
BASHKIA DURRES DVASHK/ZVASHK DURRES ZONA KADASTRALE 8517 NUMRI PASURISE [illegible] INDEX HARTE [illegible]

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE TRUALL SIP.PASURISE=145994 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= - m2 NUMRI KATEVE - NUMRI FEMERE

X 452552
Y 4582553

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




452552
4581311

SH 1:2500

X 454559
Y 4591311

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | V | | | 344/3 | | |
| 2 | J | | | 332/1 | | |
| 3 | L | | | 339/2 | | |
| 4 | P | | | 337/1 | | |

REALIZOI PER BASHKINE DURRES

PUNOI: FATJON ZEQIRI
ERVIS BAHITI

DREJTUES SEKTORI PRONAVE: PRANVERA GAGANI
NENSHKRIMI

DREJTORIA LIGJORE : ELO [illegible]ANI
NENSHKRIMI

SEKRETAR: EMIRIANA SAKO
NENSHKRIMI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SEKRETARIA BASHKIA DURRES

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:____________

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:_KP;HK.

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI____________

NENSHKRIMI ________

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-[illegible]

BASHKIA DURRËS
31 07 23 6720/4

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr.525/2 prot.

Durrës, më 31.07.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 135 datë 27.07.2023 "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të bashkisë Durrës, të pronës së paluajtshme me numër pasurie 36, zk 8517; nr. 37,zk 8517, nr. 338/2, zk 8517, dhe nr. 338/1, zk 8517, që do të përdoren nëfushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, dhe për realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkisë.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS